

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE**

**PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT**

**LËNDA: Gjuha frënge**

**(klasa e tetë)**

**Tiranë, 2005**

## **PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

- I. TË PËRGJITHSHME
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE
- III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
- IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT
  - 1.Sfera tematike dhe leksiku
  - 2.Aktet, funksionet komunikuese
  - 3.Elemente dhe struktura gramatikore
  - 4.Shpërndarja e orëve
- V. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- VI. VLERËSIMI DHE VETËVLËRËSIMI

## **I.TË PËRGJITHSHME**

Në bazë të planit të ri mësimor, gjuha frënge në klasën e 8 të shkollës 9-vjeçare zhvillohet me tri orë në javë, gjë që krijon mundësi më të mëdha për të realizuar objektivat e përcaktuar nga ky program.

I mbështetur në objektiva gjuhësorë, sociokulturorë dhe intelektualë, realizimi i këtij programi i jep një shtysë të mëtejshme formimit të përgjithshëm të nxënësve, duke forcuar dhe duke thelluar njohuritë e marra në vitet mëparshme, pasuron mundësitë e shprehjes së nxënësve, u mëson të shprehin botën e tyre të brendshme dhe u krijojnë kushtet për shkëmbime gjuhësore në të ardhmen.

Mësimi i gjuhës frënge është i pandarë nga mësimi i një apo më shumë kulturave; nëpërmjet të mësuarit të gjuhës nxënësit njohin zakone të tjera, mënyra të tjera të menduarit e të jetuarit, vlera të tjera.

Përmbajtja dhe realizimi i këtij programi ka për qëllim t'u mësojë nxënësve gjithashtu të respektojnë tjetrin, që është i ndryshëm nga ai, të kenë ndjenjën e relativitetit dhe shpirtin e tolerancës, vlera këto që marrin përmasa gjithnjë e më të domosdoshme sot që vendi ynë synon të integrohet në gjirin e Evropës shumëgjuhësore dhe ndërkulturore.

## **II. SYNIME EDUKATIVE DIDAKTIKE**

### **a. Synime edukative**

Nëpërmjet mësimit të gjuhës frënge në këtë nivel, nxënësit i hapet një dritare tjetër nga ku mund të shikojë realitete të tjera, moshatarë që jetojnë dhe mendojnë ndryshe, që kanë interesa të ndryshme, gjë që e bën të mbajë qëndrim më mirë dhe në mënyrë relative për vendin dhe gjuhën e tij, për mënyrën e jetesës dhe kulturën e tij.

Gjatë procesit mësimor për përvetësimin e gjuhës frënge, nxënësit marrin edhe një formim të përgjithshëm nëpërmjet organizimit të veprimtarive të larmishme në klasë.

Gjatë veprimtarive komunikuese nxënësit mësohen se kur duhet ta marrin fjalën dhe sa duhet ta mbajnë atë; kur duhet të përfundojnë bisedën dhe si duhet ta përfundojnë atë; kur dhe si duhet të kërkojnë leje për t'u larguar; si duhet t'u drejtohen bashkëfolësve etj.

Nxënësit mësohen të dëgjojnë dhe të respektojnë mendimin e tjetrit.

Programi, nëpërmjet veprimtarive që propozon, nxit frymën e bashkëpunimit dhe të solidaritetit me anë të punës në grupe; nxit të menduarit kritik dhe punën krijuese të pavarur në mënyrë që procesi i përvetësimit të gjuhës frënge të mos kufizohet vetëm brenda mureve të klasës, por të vazhdojë edhe në shtëpi dhe në mjediset publike nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve audiovizuale dhe të teknologjive të reja të informacionit.

### **b. Objektiva didaktikë**

Objektivi madhor i mësimit të gjuhës frënge është përvetësimi dhe përdorimi i saj si mjet komunikimi për t'u orientuar në situata jetësore të ndryshme e të larmishme, në të cilat mund të ndodhet nxënësi në të ardhmen.

Përmbushja e këtij objektivi përfundimtar kërkon ndërtimin e aftësive të veçanta dhe përmbushjen e objektivave specifike shkallë pas shkalle gjatë gjithë procesit mësuesor të këtij viti shkollor.

Përmbajtja dhe realizimi i këtij programi synon ndërtimin e një progresioni në formë spirale duke rimarrë dhe duke pasuruar në mënyrë konstante atë që është mësuar më parë, por që mund të jetë harruar.

Në përfundim të këtij programi nxënësi arrin nivelin B1 (pragu i njohjes gjuhësore) sipas kuadrit të përbashkët evropian të referencës për gjuhët e huaja.

Duke u nisur nga karakteri dhe përbërja e klasës, nga niveli dhe veçoritë psikologjike të nxënësve, si edhe nga kushtet materiale në dispozicion, mësuesi do të duhet të përdorë një metodologji të diferencuar.

Mësimi i gjuhës kërkon vazhdimisht organizimin e veprimtarive të larmishme motivuese në grupe, kolektive ose individuale, duke i alternuar me njëra-tjetrën në mënyrë që të thyhet monotonja e përditshme. Këto veprimtari nxisin interesin për të mësuar dhe për të komunikuar me njëri-tjetrin.

Përdorimi i mjeteve audiovizuale dhe teknologjive të reja të informacionit ndihmojnë në rritjen e autonomisë së të nxënësit, duke pasuruar teknikën dhe strategjitë e të nxënësit dhe mësuesit.

Mësuesi duhet të nxisë dhe të ndihmojë nxënësit që të zhvillojnë metodat vetjake të punës që do t'u mundësojnë atyre të punojnë në mënyrë të pavarur.

### **III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE**

Gjuha frënge në këtë nivel ngërthen të katër komponentët e saj : dëgjim-kuptimi; leximi, të folurit dhe shkrimi. Këta komponentë së bashku përbejnë aftësinë e komunikimit. Për të arritur deri në këtë nivel, nxënësi përdor gjuhën edhe si objekt njohjeje, edhe si mjet për të realizuar objektivin përfundimtar: komunikimin praktik me anë të gjuhës frënge. Në fund të klasës së 8-të dhe pas realizimit të këtij programi, nxënësi do të jetë i aftë:

#### **1. Në kuptimin gojor (dëgjimi)**

- Të dëgjojë dhe të kuptojë një mesazh me natyrë të shumëllojshme (tregim, bisedë, buletin informacioni, publicitet etj. ), i cili të shprehet në gjuhë standarde, të mos ketë mbingarkesë leksikore ose sintaksore dhe të jetë regjistruar në mënyrë cilësore, duke mos e zgjatur më shumë se një minutë.
- Ndjek biseda të përditshme të shqiptuara qartë, që i drejtohen atij dhe shpesh kërkon që t'i përsëriten fjalë ose shprehje të veçanta.
- Ndjek thelbin e një bisede disi të gjatë që zhvillohet rreth tij, kur gjuha e folur është standarde dhe e shqiptuar qartë.
- Dëgjon një tekst të shkurtër dhe ngre hipoteza për atë që do të ndodhë më pas.
- Kupton çështjet kryesore të një buletini lajmesh, si edhe materiale të tjera të regjistruara për probleme që i nteresojnë atij vetë, kur ato janë të shprehura ngadalë dhe qartë, si edhe të mbështetura me mjete vizuale (veprime apo figura).
- Kap thelbin e programeve televizive me tema të njohura, të shprehura qartë dhe ngadalë, si edhe të shoqëruara me mjete pamore (veprime, figura).

- Kupton të dhëna të thjeshta teknike për përdorim nga ana e tij, si: të dhëna për një kompjuter, makinë llogaritëse, televizor, magnetofon, CD etj.

Arritja e aftësisë në dëgjim do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë:

- *Dialogjesh* që lidhen me:
  - situata në familje, në mjedisin shkollor, në mjedise publike (dyqan, bar etj.), kremtime, hartime ftesash;
  - situata me lojërat dhe kohën e lirë;
  - informacione për shkollën, familjen, argëtimin etj.;
- *Monologjesh* që lidhen me:
  - lajmërimë shkollore, njoftime të shkurtëra radiotelevizive,

përshëndetje me mysafirët, biseda me ta.

## **2. Të folurit**

Në përfundim të këtij programi nxënësi:

- Fillon, vazhdon dhe përfundon me bashkëfolësin një bisedë për një temë shumë të njohur dhe që paraqet interes për të.
- Merr pjesë në një diskutim, por mund të ndodhë që të mos kuptohet plotësisht nga bashkëfolësi për atë që dëshiron të thotë. Kërkon të ndihmohet nga bashkëfolësi, duke ia përsëritur më ngadalë e më qartë mesazhin.
- Përballon situatat që mund t'i paraqiten gjatë një udhëtimi, si: rezervimi i biletës, marrja e informacionit për të gjetur një rrugë dhe ndjek këshillat për këtë gjë etj.
- Shpreh ndjenja të tilla, si: habia, gëzimi, trishtimi, indiferenca etj. dhe reagon ndaj të njëjtave ndjenja të shprehura nga të tjerët.
- Shpreh një pikëpamje apo mendime vetjake në një diskutim mes të njohurish.
- Shprehet me mirësjellje kur pranon diçka ose jo.
- Tregon me hollësi histori të shkurtëra, duke përshkruar edhe ndjenjat e reagimet e tij.
- Tregon përmbajtjen e një libri apo të një filmi, duke përshkruar edhe ndjenja e reagimet e tij.
- Zotëron një fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur (herë-herë duke perifrastuar dhe duke kompensuar me fjalë më të njohura) për shumicën e temave që lidhen me jetën e përditshme.

Arritja e aftësisë së të folurit do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë:

- *Monologjesh* në të cilat:
  - di të flasë për veten, familjen, miqtë, vende, persona, botën e imagjinatës dhe të krijimtarisë etj.;
  - flet për mësimet, për kohën e lirë, pasionet, zakonet vetjake, kulturën popullore, përshkruan një përvojë të caktuar;
    - bashkëveprimi* me mësuesin/nxënësit për tema të njohura;
    - role-play* të thjeshta, në të cilat riprodhohen situata të njohura.

## **3. Të lexuarit**

Në përfundim të këtij programi nxënësi

- kupton çështjet kryesore në artikuj të shkurtër gazetash apo revistash për tema aktuale të njohura.

- Nxjerr nga teksti kuptimin e fjalëve të panjohura dhe shprehjeve të veçanta kur tematika është e njohur dhe me interes për të.
- Kupton informacionin më të rëndësishëm në broshura të thjeshta me temë nga jeta e përditshme.
- Kupton mesazhe të thjeshta dhe letra standarde rreth udhëtimeve, shërbimeve postare, blerjeve etj., pjesë të korrespondencës që bëjnë fjalë për ngjarje, ndjenja apo dëshira të grup-moshës së vet.
- Kupton subjektin e një tregimi të strukturuar mirë dhe dallon ngjarjet më të rëndësishme, si edhe elementet thelbësore në to.
- Kupton udhëzime në doracakë të thjeshtë për përdorimin e mjeteve elektroshtëpiake, telefoni, kompjuteri etj.

#### **4. Të shkruarit**

Në përfundim të këtij programi nxënësi:

- Shkruan tekste të thjeshta për tema të ndryshme, duke lidhur në seri elementet më të rëndësishme.
- Përshkruan një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar me fjalë të thjeshta për një gazetë shkolle apo për rrethin jashtëshkollor ku ai bën pjesë.
- Mund të shkruajë letra për shokët apo të njohurit për t'i pyetur apo për t'u kërkuar diçka, si edhe për t'u dhënë informacion për një ngjarje apo ndodhi, duke shprehur ndjenjat e tij, si: gëzimin, trishtimin, habinë, simpatinë apo keqardhjen.
- Mund të kërkojë më shkrim informacione për një prodhim të ri apo për një lajm që u përgjigjet interesave të tij.
- Harton letra, kartolina, SMS dhe tekste të shkurtëra mjaft të kuptueshme me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë për veprimtarinë e përditshme apo për fushën ku ka interes.
- Krijon dialogje të shkurtëra me temë të njohur, duke vënë në zbatim njohuritë e marra në gjuhën frënge gjatë procesit mësimor.

Arritja e aftësisë në të shkruar do të realizohet nëpërmjet materialesh të shkruara, si:

- module apo formularë (shkolle, biblioteke etj.);
- kartolina, letra;
- lajmërime në një kënd lajmërimesh apo në gazeta për fëmijë, receta kuzhine, përgatitje posterash, përdorim materialesh burimeve etj.

### **IV.PËRMBAJTAJA E PROGRAMIT**

#### **1.Tematika dhe leksiku**

Përmbajtja e programit bëhet në formë spirale dhe rimarrja e njohurive vjen natyrshëm duke u mbështetur në njohuritë leksiko-gramatikore të klasës së shtatë, por pa rënë në përsëritje të rëndomta, si dhe duke sjellë tematika të larmishme dhe interesante, të përshtatshme për këtë moshe, duke synuar krijimin e një klime komunikimi në gjuhën frënge.

#### **Temat :**

**1-Jeta e përditshme:**

- miqtë ,njohjet e reja,

- mbrëmjet, vizitat, festat,
- bota e kulturës dhe e medias,
- të rinjtë dhe moda,
- profesionet.

## 2-Jeta publike:

- shëndeti, mjekësia,
- dyqanet,supermarketet,
- restorantet,hotelet,
- dokumentet zyrtare,
- ndeshje sporti,konkurse,
- fletëpalosje, lajmërimet, letra zyrtare,

## 3-Udhëtimet dhe turizmi:

- aeroporte, porte, stacione të trenit,
- shoqëritë e shërbimit,
- agjensitë e udhëtimit.

## 4-Natyra, mjedisi:

- ekologjia ,ndotja e mjedisit,
- mjedisi dhe shoqëria në të ardhmen,
- edukimi, kultura.

## 5-Jeta personale:

- kujtimet, bota e shkollës, lojërat,
- profesionet,
- projekte për të ardhmen.

## 2. Aktet e komunikimit

demander et donner son avis

comment vous le , la , trouvez?

Quell est votre avis ? A mon avis , d'après moi , je pense que ...

Exprimer son appréciation /dépreciation

C' est agreeable , c' est delicieux .

Exprimer sa surprise , sa sympathie, sa joie , sa craintes

J' ai tres peur de prendre l avion

Je crains la foule , l altitude

Ça me surprend , ça m' etonne.

Exprimer son idifference:

Ça m' est égale, et alors ? peu m ' importe ...

Engager , continuer et terminer une conversation

Dis donc , tu sais que.....

A propos .....

Ça me fait penser que.....etc.

Parler de son état physique :

Je me sens bien /, je me sens mal, faible , fatigué

Je suis en forme / souffrante.

Faire/ accepter un compliment

Tu as bonne mine aujourd' hui

Elle est chouette ta robe

Exprimer son intension , son espoir, sa volonté  
Je voudrais , j' aimerais j' ai l' intension de .....  
J' ai envie de.....je tiens à  
Encourager  
Allez ,du courage , n' hesitez pas....etc

### 3. Elementet dhe struktura gramatikore

Në futjen dhe trajtimin e elementeve dhe strukturave të reja gramatikore duhet pesur parasysh edhe trajtimi dhe zhvillimi i materialit gramatikor të njohur, duke rimarrë dhe duke pasuruar më tej në vijueshmëri rrezen e njohurive gjuhësore.

Krahas tyre do të trajtohen edhe këto njohuri të reja:

Adjectif indéfinis ,meme ,tout

L' ordre des mots dans la phrase

Verbe :connaître , savoir

Phrase négative:personne.....ne , rien,.....ne

Discours indirect

Construction faire + infinitif

Utilisation et formation du conditionnel [politesse, conseil souhait ] si +present + future

Si +imparfait,+conditionnel

Constructions prépositionnelles ... commencer à , finir de .....etc.

Les adverbes en - ment

Subjonctif : ordre souhait,interdiction, il faut que +sub

### Fonologji

Fonetika ka për qëllim të përsosë shqiptimin e nxënësit në fjalë dhe fjali me intonacione dhe muzikalitetin e duhur.

### V.Shpërndarja e orëve

35 javë x 3 orë = 105 orë vjetore

Aspekti komunikues-  
kulturor: 57 orë

Aspekti gjuhësor: 38 orë

Të lira: 10 orë

Gjithsej: 105 orë

*Aspekti komunikues- kulturor (32 orë).* Pa rënë ndesh me parimin e autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, përgjithësisht këshillohet që afër 32 orë mësimore t'u kushtohen veprimtarive me karakter komunikues, përfshirë këtu të ushtruarit, në situata komunikimi të njohurive, strukturave, nocioneve që ngërthejnë materialet e ndryshme didaktike, si: teksti, materiale integruese etj., rimarrjen dhe përsëritjen e njohurive të fituara deri në atë pikë, rimarrjen



dhe përforcimin deri në ngulitje të funksioneve, nocioneve e strukturave komunikuese më të rëndësishme.

*Aspekti gjuhësor (28 orë).* Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi ftohet të shtjellojë, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore, ushtrime gjuhësore (gramatikore e leksikore), rimarrje dhe përforcim të atyre të mësuara më parë apo edhe të atyre të reja.

*Të lira (10 orë).* Në këto orë të lëna në dispozicion të mësuesit, mund të zhvillohen orë përsëritjeje, detyra kontrolli, plotësime të orëve kushtuar aspektit qoftë komunikues, qoftë gjuhësor.

## **VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PROGRAMIT**

Me zbatimin e këtij programi mësuesi është i lirë të zgjedhë metodën që dëshiron për të përdorur, mjafton që të realizojë kërkesat që shtrohen dhe objektivat e parashikuar për këtë nivel, bazuar në standardet e arritjeve. Në metodat e reja komunikuese nxënësi gjen vetveten dhe është më i lirshëm për t'u shprehur. Këshillohet puna në grupe dhe çifte, mbasi informacioni përgatitet nga të gjithë dhe nxënësi, edhe ai më i ndrojturi, aktivizohet në orën e mësimit duke ndarë kështu përgjegjësinë për suksesin apo humbjen dhe duke u ndjerë të gjithë të vlerësuar.

Roli i nxënësit bëhet më i dukshëm duke qenë se tashmë është ai në qendër të procesit të të mësuarit, duke hyrë në marrëdhënie ndërveprimi dhe komunikimi me nxënësit e tjerë.

Roli i mësuesit ndryshon. Ai është mbështetës, nxitës dhe udhëheqës i veprimtarive individuale dhe kolektive të nxënësit, duke nxitur dhe duke krijuar situata reale mësimore.

## **VII. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI**

Të kontrollosh dhe të vlerësosh do të thotë të verifikosh se përgjigjet e dhëna nga nxënësi korrespondojnë me atë çka diktojnë normat gramatikore dhe gjuhësore.

Vlerësimi ka për qëllim matjen e përparimit dhe të arritjeve në gjuhë të huaj. Format e ndryshme të larmishme të vlerësimit u krijojnë mundësi nxënësve për të konsoliduar njohuritë e tyre si në klasë, ashtu edhe në shtëpi, duke u dhënë detyra të studiuara, specifike me objektiva të qartë që përforcojnë dhe çojnë më tej njohuritë e fituara. Kontrolli gojor me gjithë karakterin subjektiv, mbetet një element i rëndësishëm i vlerësimit të arritjeve në klasë. Vetëvlerësimi e mundëson nxënësin të testojë njohuritë e tij nëpërmjet veprimtarive të shkurtëra efikase. Rezultati e ndërëgjegjëson ata për arritjet dhe mangësitë, duke e ndihmuar për t'i kapërcyer ato.

Vlerësimi mund të jetë i formave të ndryshme. Ai mund të jetë vlerësim në vazhdimësi ose vlerësim i përpiktë, i cili bëhet gjatë testimeve ose vlerësimeve të tjera në një datë të caktuar. Vlerësimi formativ i lejon mësuesit të marrë një informacion të plotë për pikat e forta dhe të dobëta të njohurive të nxënësve etj.

## **KRITERE TË HARTIMIT TË TEKSTIT TË KLASËS VIII TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE**

Për hartimin e tekstit, të mbahen parasysh grup-mosha së cilës i drejtohet dhe në sa orë javore dhe vjetore do të zhvillohet kjo metodë.

Fakti i të mësuarit është një proces i natyrshëm që qëndron në ndjekjen e objektivave të mirëpërcaktuar. Për këtë kërkohet:

-Objektiva të qarta leksiko-gramatikore, si:

1. Të mësosh të komunikosh në frëngjishte me gojë dhe me shkrim.

2. Të mësosh funksionimin progresiv të gjuhës.

3. Të njohësh Francën dhe botën frankofone, si e tillë të propozohen teknika dhe strategji që lehtësojnë mësimdhënien dhe e çojnë nxënësin në një autonomi të tijën.

-Teksti të jetë i ndarë në njësi didaktike.

-Tematika e zgjedhur të përfshijë veprimtari të jetës së përditshme sa më afër interesave të nxënësve, në mënyrë që të mund të flasim për veten e tyre, personat që i rrethojnë etj.

-Të jetë me materiale autentik me ilustrime me ngjyra.

-Të ketë strategji ndërvepruese për të zhvilluar tek nxënësit:” Unë di të bëj” (Savoir-faire), “Unë di të jem” (Savoir etre).

-Gramatika të jetë e ndërthurur me objektivat e komunikimit.

-T’i përshtatet zhvillimit emocional të nxënësve.

-Të ketë format të madh për një pamje të mirë nga ana e nxënësve.

-Të ketë ushtrime për zhvillimin e imagjinatës, lidhjen ndërlëndore, histori, gjeografi etj.

-Të ketë një baraspeshë ndërmjet veprimtarive vetjake dhe kolektive.

-Të mbështetet në katër aftesitë.

-Rubrika “Civilisation” (Qyteterim) i ndërgjegjëson nxënësit për pasurinë dhe diversitetin e kulturës botërore dhe nxit tek ta dëshirën për të hyrë në komunikim me të rinjtë e moshës së tyre. Veprimtaritë të bëhen të gërshetuara me mësimet nëpërmjet teksteve të shumta dhe fotografive.

-Metoda të shoqërohet me një libër të veçantë ushtrimesh, ku nxënësi të mund të punojë në mënyrë të pavarur.

-Metoda të shoqërohet me kasetë dhe me libër për mësuesin.